

VENDIM
Nr.597, datë 28.5.2009

**PËR NDRYSHIMIN E EMRIT DHE PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË
STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE “UFO
DENTAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërtimi dhe emri i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental”, ndryshon në universiteti privat “Ufo University”.

2. Lejimin e universitetit privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushën “Psikologji klinike”.

3. Kohëzgjatja normale e programit të studimit të ciklit të dytë të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND) në psikologji klinike.

4. Lejimin e universitetit privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë” në fushat:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;
- b) Shkenca penale;
- c) E drejtë private;
- ç) Qeverisje dhe administrim publik.

5. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” janë pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;
- b) Shkenca penale;
- c) E drejtë private;
- ç) Qeverisje dhe administrim publik.

6. Lejimin e universitetit, privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të dytë” në fushën: “Studime për sigurinë”.

7. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” të jetë program i studimit të ciklit të tretë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) në “Studime për sigurinë”.

8. Ngarkohet universiteti, privat “Ufo University”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

9. Universiteti privat “Ufo University” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 2, 4 e 6 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

10. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Universiteti privat “Ufo University” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit dhe

këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha